



Titulli i projektit

Program për zëvendësimin e çatave me eternit/llamarinë në Komunën Këlmend

Tipi i projektit

Sektori strategjik i turizmit

Vendndodhja e projektit

Komuna Kelmend, Zona Funksionale Malësi e Madhe

Buxheti i paravlerësuar

350,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në Kelmend, gjenden sot 105 shtëpi me çati të ndërtuara nga materiali eternit (me bazë asbesti). Ky material është përdorur gjerësisht në ndërtim në dekadat e mëparshme, por më vonë është vlerësuar në shkallë ndërkombëtare shumë i dëmshëm për shëndetin e njerëzve që ekspozohen direkt me të gjatë punës, ose dhe gjatë jetesës në shtëpi.

Largimi i çatave me eternit është një domosdoshmëri në dy drejtime: për sigurimin e shëndetit të banorëve dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonën funksionale të Malësisë së Madhe.

Gjithashtu në Komunën Kelmend janë të përhapura dhe çatitë me llamarinë, të cilat nuk janë një element tërheqës për vizitorët.

Duke qenë se turizmi është një nga dy sektorët strategjikë të gjetur nga analiza ekonomike e zonës funksionale dhe Kelmendi është një nga zonat me potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit malor e alpin në të ardhmen, është i nevojshëm zëvendësimi i këtyre dy materialeve të ndërtimit të çatave me materiale më të përshtatshme.

Qëllimi/et specifik të projektit

Projekti mund të shihet i përbërë nga dy komponente:

1. Zëvendësimi i çatave me eternit në zonat turistike të Komunës Kelmend.
2. Zëvendësimi i çatave me llamarinë në zonat turistike të Komunës Kelmend.

Zbatimi i këtyre dy komponentëve do të sillte një përfitim të drejtpërdrejtë në shëndetin e banorëve që aktualisht jetojnë në këto shtëpi. Gjithashtu ato do të jenë në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në këtë zonë.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultati i programit janë shtëpitë me çati të ndërtuara nga materiale bashkëkohore, të padëmshme për shëndetin e banorëve dhe karakteristike të fshatrave malorë të Komunës Kelmend.

Numri i shtëpive që mund të përfitojnë nga komponenti i parë i projektit (largimi i çatave me eternit) arrin deri në 105.

Me ndërtimin e çatave me materiale karakteristike të zonave malore në Kelmend, përfitojnë të gjithë banorët e zonës funksionale Malësi e Madhe, rreth 54555 banorë gjithsej, në formën e shtimit të numrit të vizitorëve.

PROJEKTI 5



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të projektit janë largimi i çatave me eternit apo llamarinë nga një numri shtëpish dhe rindërtimi i tyre me material të padëmshëm për shëndetin dhe karakteristik për zonën alpine të Kelmendit.

Maturimi i projektit

Çështja e çatave të ndërtuara me eternit në zonën turistike të Këlmendit është ngritur në analizën e sektorit strategjik të turizmit, nisur nga të dhënat e marra nga shoqëria italiane V.I.S, e cila mbështet prej disa vitesh zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm alpin në Komunën Kelmend dhe Shkrel. Programi i propozuar këtu është një ide që vjen në përgjigje të kësaj çështjeje dhe rekomandimit për zgjidhjen e saj në analizë. Aktualisht është në proces tenderimi një projekt për zëvendësimin e çatave me eternit, si edhe ato me llamarinë, të fshatit Tamarë. Programi do të jetë një vazhdim i kësaj ndërmarrije nga Komuna Kelmend, duke e shtrirë më tej në fshatra të tjerë të zonës.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Lidhur me projektin janë identifikuar këta donatorë të mundshëm: BE, buxheti nga qeveria qendrore në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2014-2020, GIZ, si dhe Ministria e Shëndetësisë. Këta donatorë janë evidentuar si të mundshëm, nisur nga madhësia e projektit dhe natyra e tij.

Kostot e projektit

Sipas informacioneve nga Komuna Këlmend, kostoja e heqjes së çatave me eternit ose llamarinë dhe e rindërtimit të tyre me material druri është vlerësuar rreth 70 EUR/m², ndërsa sipërfaqja mesatare e një shtëpie në këtë zonë është 100 m². Kështu, për një shtëpi, kostoja e këtij projekti mund të përafrohet në 7,000 EUR.

Kostoja e zëvendësimit e përlogaritur për 50 shtëpi është 35,000 Euro.